BULETIN MUJOR

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT



Financimit i Doktoraturave, dyfishohet mbështetja për doktorantët

Ministria e Arsimit dhe Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit kanë hapur thirrjen për Programin Kombëtar të Financimit të Studimeve të Doktoraturës 2026. Me një buxhet mbi 600 mijë euro, mbështetja për doktorantët dyfishohet krahasuar me vitin e kaluar, duke ofruar deri në 10 mijë euro për doktoraturat standarde dhe 30 mijë euro për ato industriale. Programi synon të forcojë kërkimin shkencor, inovacionin dhe zhvillimin e studiuesve të rinj, me fokus të veçantë në fushat STEM. Aplikimet janë paraqitur nga institucionet e arsimit të lartë gjatë muajit tetor 2026.



Viti i ri akademik 2026–2027, zgjerohen programet me diploma të dyfishta dhe bashkëpunimet europiane

Ministrja e Arsimit, Mirela Kumbaro, uroi nisjen e vitit akademik 2026-2027 nga Universiteti “Aleksandër Moisiu” në Durrës, ku u inaugurua godina e re e Fakultetit të Studimeve Profesionale. Këtë vit, Universiteti i Durrësit mirëpret mbi 1,900 studentë të rinj, ndërsa në arsimin e lartë po zgjerohen programet e përbashkëta dhe diplomat e dyfishta me institucione europiane. Gjithashtu, 26 programe të reja i shtohen ofertës së studimeve në gjuhën angleze. Ministrja vlerësoi edhe renditjen e Universitetit të Tiranës në Times Higher Education, si universiteti i parë shqiptar i përfshirë në këtë klasifikim ndërkombëtar.



Godinë e re dhe teknologji moderne për Agjencinë Kombëtare të Shërbimeve Arsimore

Ka nisur projekti për ndërtimin e ambienteve të reja të Agjencisë Kombëtare të Shërbimeve Arsimore (AKSHA), në kuadër të bashkëpunimit mes Ministrisë së Arsimit dhe Fondacionit Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim (AADF).
Investimi prej 2.7 milionë dollarësh parashikon një godinë moderne prej rreth 3,500 m^2 dhe pajisjen e saj me infrastrukturë bashkëkohore teknologjike.
Kapaciteti për provimet digjitale do të rritet nga 57 në 213 poste testimi, ndërsa institucioni do të ketë pesë salla testimi dhe pesë salla monitorimi. Projekti synon të rrisë sigurinë, transparencën dhe cilësinë e administrimit të provimeve kombëtare dhe certifikimeve profesionale.



Tirana mirëpriti mbledhjen e Bordit Drejtues të PISA

Tirana mirëpriti Mbledhjen e Bordit Drejtues të PISA-s, me përfaqësues nga 91 vende, në një aktivitet treditësh kushtuar zhvillimit dhe të ardhmes së vlerësimit ndërkombëtar të nxënësve. Ministrja e Arsimit, Mirela Kumbaro, dhe Drejtori për Edukimin dhe Aftësitë në OECD, Andreas Schleicher, morën pjesë në ceremoninë e hapjes. Në fokus të diskutimeve ishin cilësia e arsimit, aftësitë bazë, mendimi kritik dhe ndikimi i teknologjisë e inteligjencës artificiale në procesin mësimor.
Shqipëria shënoi përmirësim të ndjeshëm në PISA 2025 krahasuar me vitin 2022, me rritje prej 65 pikësh në matematikë, 59 në shkencë dhe 50 në lexim.



Diplomohen 500 studentë në Universitetin e Sporteve

Ministrja e Arsimit, Mirela Kumbaro, ka zhvilluar një tur takimesh me drejtuesit e shkollave për zbatimin e udhëzimit për vitin shkollor 2026–2027 dhe të rregulloreve të shkollave, me qëllim rritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe mbarëvajtjen e procesit mësimor. Në takimet e zhvilluara me drejtuesit dhe mësuesit, Kumbaro nënvizoi rëndësinë e komunikimit, zbatimin të rregullave të ndalimit të telefonit në shkollë, si dhe rritjen e vigjilencës nga drejtuesit për çdo problematikë që haset në përditshmëri. Kumbaro ka theksuar edhe kalendarin e aktiviteteve nga olimpiadat kombëtare, tek “Lëvizja për lexim 2.0” e cila do të nisë së shpejti.